

KONTRATE THEMELIMI
PER SHOQERINE TREGTARE
“T.N.T. EXPRESS ALBANIA” SH.P.K.

ME SELI NE TIRANE

Sot, me date 23.01.06, Ortakët Themelues:

1. **Z. Dionis Teqja**, i datëlindjes 25.06.1969, lindur në Peqin dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. 1155900
2. **Z. Fatos Aliaj**, i biri i Fejziut, i datëlindjes 09.05.1970, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë në adresën Rruga “Mustafa Lleshi”, Pall 3, Shk. 3, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0085431

vendosën të krijojnë Shoqërine Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar “T. N. T. EXPRESS ALBANIA” SH.P.K.

NENI 1
Emërtimi dhe selia

Shoqëria Tregtare “T.N.T. EXPRESS ALBANIA ” Sh.p.k. themelohet si Shoqëri Tregtare, bazuar ne ligjin Nr. 7638, date 09.11.1992 “ Per Shoqerite Tregtare”. Ajo është Person Juridik Privat Shqiptar.

Selia e saj ndodhet në adresën Rruga “Mine Peza”, Nr. 2, Tirane.


NENI 2
Legjislacioni i aplikueshëm


Veprimitaria e Shoqërisë bazohet në normat e kësaj Kontrate Themelimi, Statutit të Shoqërisë si dhe legjislacionit Shqiptar në fuqi.
Themeluesit e saj mbajnë përgjegjësi vetëm për detyrimet që krijon Shoqëria.

NENI 3
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues në vlerën 100.000 (njëqindmijë) lekë me vlerë nominale të një kuote 1000 lekë.

Kuotat e Shoqërisë janë të ndara si më poshtë :



- 
1. **Z. Dionis Teqja**, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 50% të kuotave ose 50 kuota të barabarta me vlerën 50.000 lekë, në kapitalin themeltar.
 2. **Z. Fatos Aliaj**, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 50% të kuotave ose 50 kuota të barabarta me vlerën 50.000 lekë, në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar është investuar nga Ortakët Themelues në tërësine e tij dhe në përpjestim me pjesët takuese te secilit.

Vlerësimi dhe shlyerja e kapitalit themeltar është bërë nga Ortakët Themelues me rastin e miratimit të kësaj kontrate themelimi dhe është nënshkruar prej tyre.

NENI 4.

Shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar

Shoqëria ka të depozituar në Bankën "Alfa Bank" me seli në Tirane, kapitalin në të holla, i cili depozitohet në llogarinë "Shoqëri në Formim e Sipër" në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi.

Pas regjistrimit të Shoqërisë, kjo shumë do të kalojë në llogarinë e kësaj Shoqërie që do të çelet pranë Bankës "Alfa Bank" Tiranë.

Në llogarinë e Shoqërisë çelet llogaria "Fondi Themeltar i Ortakëve" ku regjistrohet sasia e kapitalit të tyre.

NENI 5.

Objekti i veprimtarisë të shoqërisë.


Shoqëria do te ketë si objekt të përgjithshëm të veprimtarisë së saj:

- Kryerjen e shërbimeve postare të llojeve të ndryshme, dërgesave postare si zarfe, dokumenta, pako ose ngarkesa te ndryshme nëpërmjet tokës, detit dhe ajrit ne Shqipëri dhe jashtë saj;
- Ushtrimin e veprimtarisë së transportit ajror, detar dhe tokësor të udhëtarëve dhe mallrave, brenda dhe jashtë territorit te Republikës së Shqipërisë;
- Tranzitim mallrash nga të gjitha pikat kufitare të Shqipërisë;
- Import dhe eksport i të gjitha llojeve të mallrave dhe tregtimi i tyre me shumicë dhe pakicë ;
- Përfaqësime ekskluzive për abonime ;

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërise

Shoqëria do të funksionojë me një afat kohor të pakufizuar. Afati i fillimit të veprimtarisë fillon pas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.



NENI 7 Heqja dorë

Ortakët themelues mund të heqin dorë nga Shoqëria, por gjithnjë për shkaqe të përligjura. Heqja dorë nuk i shkarkon Ortakët, nga detyrimet e Shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë.

NENI 8 Administrimi i fitimeve

Fitimi i realizuar kalon në pronësi të ortakëve themelues. Fitimi është lirisht i transferueshëm brenda dhe jashtë shtetit shqiptar.

NENI 9 Detyrimet e ortakëve

Ortakët Themelues kanë sidomos këto detyrime:

- Të regjistrojnë Shoqërinë në Regjistrin Tregtar dhe të marrin lejet e nevojshme të ushtrimit të aktivitetit të veprimtarisë së tyre.
- Të derdhin kapitalin e nevojshëm për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë.
- Të sigurojnë mjediset e nevojshme për fillimin e aktivitetit.
- Të sigurojnë mundësinë e specializimit të fuqisë punëtore dhe specialistëve për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë.
- Të sigurojnë objektet e Shoqërisë dhe sendet që janë objekt i veprimtarisë së saj nga çdo lloj dëmtimi.
- Të menaxhojnë prodhimin e ta reklamojnë atë nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit.

NENI 10 Organet drejtuese të Shoqërisë janë :

- 1) Asamblea e Ortakëve.
- 2) Administratori.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë “T.N.T. EXPRESS ALBANIA” Sh.p.k. do të jetë Z. Thanas HYSENI.

NENI 11 Përgjegjësia kundrejt shoqërisë

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.



NENI 12**Pjesëmarrja në shoqëri ose aktivitete të tjera**

Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, por jo konkurues me atë të shoqërisë së themeluar prej tyre.


NENI 13**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga Ortakët themelues të Shoqërisë dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

NENI 14

Kontrata e themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues u nënshkrua prej tyre pa vërejtje para Noterit të vendit të themelimit të Shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES**Dionis TEQJA**
Dionis Teqja**Fatos ALIAJ**
Fatos Aliaj

S T A T U T I

I SHOQERISE TREGTARE “T.N.T. EXPRESS ALBANIA” SH.P.K.

ME SELI NE TIRANE

I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME.

Shoqëria Tregtare “T.N.T. EXPRESS ALBANIA” Sh.p.k. rregullon pozitën e saj juridike, marredhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, dhe ne dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi, që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare.

NENI 1

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë :

- Kryerja e shërbimeve postare të llojeve të ndryshme, dërgesave postare si zarfe, dokumenta, pako ose ngarkesa te ndryshme nëpërmjet tokës, detit dhe ajrit ne Shqipëri dhe jashtë saj;
- Ushtimi i veprimtarisë së transportit ajror, detar dhe tokësor të udhëtarëve dhe mallrave, brenda dhe jashtë territorit te Republikës së Shqipërisë;
- Tranzitim mallrash nga të gjitha pikat kufitare të Shqipërisë;
- Importi dhe eksporti i të gjitha llojeve të mallrave dhe tregtimi i tyre me shumicë dhe pakicë;
- Përfaqësime ekskluzive për abonime;

NENI 2

Emërtimi dhe selia e Shoqërisë


Shoqëria është Person Juridik Privat.

Shoqëria do te paraqitet në qarkullim me emrin e saj “**T.N.T. EXPRESS ALBANIA**” Sh.p.k. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga “Mine Peza”, Nr. 2, Tiranë.

NENI 3

Regjimi Juridik i Shoqërisë

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.



Ajo është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtronet dispozitave të Kontratës së Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Me vendim të Ortakëve, Shoqëria mund të ndryshojë regjimin juridik të saj, në përputhje me dispozitat ligjore që do të janë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Kontratës të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

II. TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE.

NENI 4

Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet deri në kufirin e kapitalit të investuar. Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Ortakëve, në raport me përqindjet e kapitalit themeltar që ata zoterojnë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qera, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakëve Themelues.

NENI 5


Të drejtat e Ortakëve

Ortakët kanë të drejtë të administrojnë aktivitetin e Shoqërisë konform objektit të veprimtarisë së saj, duke përfshirë edhe veprimtarinë prodhuese e tregtuese që Shoqëria mund të kryejë, vlerat e saj intelektuale e ekonomiko – financiare, të marrë dijeni për rezultatet ekonomiko - financiare në çdo fazë të aktivitetit të saj, të marrë pjesë vetë ose me anë të përfaqësuesit në këtë aktivitet.

Ortaket kanë të drejtë të térheqin të gjithë dokumentat kryesore të Shoqërisë për tre vitet e fundit, të marrin nga Administratorët e Shoqërisë, 15 ditë para çdo mbledhje asambleje, materialet e saj dhe projektet e vendimeve.

Ata kanë të drejtë të heqin dorë nga Shoqëria dhe mund të shesin pjesën e kapitalit të tyre, në përputhje me kushtet që i lejon Statuti dhe Ligji. Heqja dorë nga Shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që kanë deri në momentin e heqjes dore dhe nuk i cënon ata në marrjen e të ardhurave, në proporcion me pjesën e tyre, që Shoqëria ka siguruar deri në këtë moment. Në rastin e heqjes dorë ata mund t'i ofrojnë pjesën e tyre të kapitalit ortakeve të tjera, në bazë të së drejtës së parablerjes dhe me refuzimin nga ana e tyre mund t'ja ofrojne këtë pjesë çdo personi tjetër të mundshëm.

Ortakët, në përputhje me Kontratën e Themelimit, me Statutin dhe legjislacionin në fuqi, kanë të drejtë që në të njëjtën kohë të janë Ortakë edhe në Shoqëri të tjera.



Ortakët kanë të drejtë që të paraqesin propozime për shqyrtimë para organeve të Shoqërisë si dhe të emërojnë e shkarkojnë Administratorin ose Administratorët, të punësuarit, ekspertin kontabël apo likuidatorët.

NENI 6

Ortakët kanë edhe këto detyrime kryesore :

- Të depozitojnë pjesën e tyre në kapitalin e Shoqërisë brenda afatit të parashikuar.
- Të derdhin kuotat suplementare në kushtet e përcaktuara në Statut.
- Të përpilen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.
- Të informojnë organet drejtuese të Shoqërisë për mundësitë e përmirësimit të aktivitetit të saj.
- Të marrin pjesë në procesin e rritjes së nivelit të specialistëve.
- Të respektojnë detyrimet që burojnë nga Kontrata e Themelimit.

NENI 7

Kohëzgjatja e Shoqërisë.

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me afat të pakufizuar.

III. KUSHTET EKONOMIKE TE SHOQERISE.

NENI 8

Parimet e funksionimit

Veprimtaria e funksionimit të Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.


NENI 9

Shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar

Kapitali fillestar i investuar nga Ortakët, përbën bazën e krijimit të fondit themelor të mjeteve të xhiros.

Administratori i dorëzon Ortakëve dokumentin vërtetues për sasitë e shumave të derdhura në fazën e themelimit.

Vlerësimi i kapitalit në natyrë është bërë nga Ortakët Themelues në momentin e themelimit të Shoqërisë.



NENI 10
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërise është i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues në vlerën 100.000 (njëqindmijë) lekë me vlerë nominale të një kuote 1000 lekë.

Kuotat e Shoqërisë janë të ndara si më poshtë :

3. **Z. Dionis Teqja**, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 50% të kuotave ose 50 kuota të barabarta me vlerën 50.000 lekë, në kapitalin themeltar.
4. **Z. Fatos Aliaj**, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 50% të kuotave ose 50 kuota të barabarta me vlerën 50.000 lekë, në kapitalin themeltar.

Pjeset e kapitalit themeltar janë paguar tërësisht nga ortakët sipas pjesëve te tyre takuese në momentin e nënshkrimit.

NENI 11
Pasuria e Shoqërisë

Shoqëria bëhet pronare e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme kur vlera e pasurisë mbulohet tërësisht në të holla.

NENI 12
Transferimi i kuotave tek pasardhësit, parardhësit dhe bashkëshorti.


Kuotat e Ortakëve mund të transferohen lirisht tek trashegimtarët ligjore e testamentarë te tyre mbas vdekjes, si dhe tek bashkëshorti tjetër me rastin e zgjidhjes së martesës. Subjektet që perfitojnë nga ky transferim detyrohen të disponojnë kapitalin e transferuar për një vit në Shoqëri, duke pasur të gjitha të drejtat e mbajtësit të tij të mëparshëm.

NENI 13

Ortakët mund të transferojnë lirisht kapitalin themelor edhe tek bashkëshorti, tek pasardhësit e paraardhësit, të cilet detyrohen që për një vit ta disponojnë këtë kapital në shoqëri. Ky transferim behet duke respektuar dispozitat e ketij Statuti dhe te ligjeve ne fuqi.

NENI 14
Forma e transferimit

Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me akt notarial, ndryshe janë të pavlefshme. Në të gjitha rastet e transferimit të kapitalit themeltar nevojitet miratimi paraprak i ortakëve të Shoqërisë.



NENI 15

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet kur për këtë vendosin Ortakët themelues.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë, duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.

Ortakët themelues vendosin për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën, Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

NENI 16

Fondet rezervë

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

NENI 17

Përdorimi i të ardhurave neto

E ardhura neto, që rezulton pasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti, nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kreditin për investime, pagat e shpërbimit, përdoret nga Ortakët sipas qëllimit të tyre.

NENI 18

Bilanci

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e themelimit të Shoqërisë. Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratorët, në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

NENI 19

Plani finanziar

Plani finanziar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose ne valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri.

Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.



IV. ORGANET E SHOQERISE.

NENI 20

Organ themelor i shoqërisë është Asamblea e Ortakëve. Asamblea e Ortakëve është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme. Asamblea e Jashtëzakonshme mund të mblidhet në çdo kohë kur organi administrativ ose vetë ortakët e vleresojne të nevojshme.

Asamblea e Ortakëve mblidhet të paktën një herë në vit për miratimin e bilancit, mbasi lajmërohet nga Administratori 15 ditë përpëra me shkrim.

Asamblea e Ortakëve vendos për të gjitha problemet, me përjashtim të atyre per te cilat është vendosur ndryshe nga Statuti.

Asamblea e Ortakëve drejtohet nga Administratori. Ai emeron një sekretar nga radhet e pjesemarrësve për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes, me përjashtim të rasteve kur ai duhet mbajtur nga një Noter sipas ligjit.

Vendimet e mbledhjes fiksohen në procesverbalin e firmosur nga Administratorët dhe sekretari ose Noteri. Në procesverbal duhet të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur, deklaratat e bëra prej Ortakëve, me kërkesë te ketyre te fundit. Vendimet e mbledhjes, të marra në përputhje me ligjin, me Kontratën e Themelimit dhe Statutin janë te detyrueshme per Ortakët, megjithëse nuk kanë diskutuar ose kundërshtuar.

V. ADMINISTRIMI I SHOQERISE.

NENI 21

Administrimi


Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Administratori.

Administrator i Shoqërisë “T.N.T. EXPRESS ALBANIA” Sh.p.k. do të jetë zoti Z. Thanas HYSENI.

Administratori përfaqëson Shoqërinë në marredhëni me të tretët si dhe para organeve të administratës dhe atyre gjyqësore.

Shoqëria mund të ketë edhe Këshill Administrativ, kur ajo e vlereson të nevojshme. Këshilli Administrativ thirret nga Administratorët e Shoqërisë për probleme të ndryshme. Njoftimi duhet të përbajë vendin, datën dhe orën e mbledhjes, si dhe çështjet që do të trajtohen. Vendimet e mbledhjes merren nga Administratorët. Ato fiksohen në procesverbal të firmosur prej tyre dhe sekretarit.

Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e organit administrativ. Administratorët janë përgjegjës individualisht dhe solidarisht ndaj shoqërisë ose ndaj të



tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për dëme të kryera gjatë administrimit.

Administratori shkarkohet me vendim të Ortakëve. Përveç kësaj Administratori mund të shkarkohet nga Gjykata me kërkesë të njerit prej Ortakëve.
Ortakët kanë të drejtë që të marrin nga Administratori të dhëna për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë.

NENI 22 **Detyrimet e administratorit**

Administratori ka këto kompetenca kryesore :

1. Të miratojë planet e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre dhe t'i paraqesin ato sipas rastit për miratimin përfundimtar Asamblesë së Ortakëve.
2. T'u bëjë propozimet përkatëse Ortakëve kur lind nevoja për ndryshime në kapitalin themeltar të shoqërisë.
3. Të miratojë aktet normative që përcaktojnë raportet në gjirin e Shoqërisë, duke përfshirë kuadrin dhe personelin.
4. Të përfaqësojë Shoqërinë në marredhënie me të tretët.
5. Të përcaktojë strukturën e aparatit të Shoqërisë dhe të krijojnë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë.
6. T'u bëjë propozime Ortakëve ne lidhje me krijimin e njësive dhe strukturave të ndryshme si filiale, degë e përfaqësi në qytete të tjera të vendit ose jashtë shtetit.
7. Të përgatisë propozimin për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe t'ja paraqesin Ortakëve për miratim. Të përzgjedhë ekspertët kontabël dhe anëtarët e komisionit të likuidimit si dhe të paraqesë propozimet për miratim para Asamblesë së Ortakëve.
8. Të sigurojë zbatimin e përpiktë të Vendimeve të Asamblese së Ortakëve.
9. Të përcaktojë numrin e punonjësve në Shoqëri.
10. Të nënshkruajë têrheqjen e shumave monetare në llogaritë bankare.

NENI 23 **Ekspertët Kontabël.**

Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo vit financiar, kur jemi përpëra rasteve rë përcaktuara në ligj. Caktimin e tyre e bën Mbledhja e Ortakëve.

Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullit të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë.

Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesit, administratorët si dhe personat që janë gjini e krushqi me ta deri në shkallën e katërt. Po ashtu nuk mund ta kryejnë këtë detyrë përgjegjësit e zyrave, filialeve dhe agjensive.

VI. MARREDHENIET E PUNES.

NENI 24

Regjimi juridik

Marredheniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Kontratës së Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontrates individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve.

Marredheniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

NENI 25

Fusha e aplikimit te kontrates individuale te punes

Kontrata individuale e punës rregullon këto marredhënie:

- Marja në punë, kushtet e të punësuarit për tu marrë në punë.
- Lloji i punës që do të kryeje i punësuari, profesionet ndihmëse, koha e punës ditore e javore, pushimi ditor e favor, shpërblimi për kohën e punës, për periudhën jashtë kohës normale të punës, për punën e natës, për ditët e pushimit dhe të festave, shpërblimi për punë të dalluar.
- Përgjegjësitë e palëve për mosrespektimin e kontratës.

NENI 26

Përgjegjësia kundrejt shoqërisë

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

VI. MBYLLJA E SHOQËRISË. LIKUJDIMI.

NENI 27

Ndërprerja e aktivitetit para afatit

Veprimtaria e Shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur Shoqëria nuk rezulton rentabël gjatë dy vjetëve të fundit radhazi dhe kur për këtë vendos Gjykata kompetente.

NENI 28

Likujdimi

Kur vendoset shperndarja e Shoqërisë dhe ne prani te njerit nga shkaqet e prishjes se kesaj te fundit, mbi propozimin e Administratorit, Mbledhja e Asamblesë të Ortakëve cakton likuidatorin që realizon likujdimin e saj. Shoqëria gjatë likujdimit mban, ne krah te emërtimit, edhe emrin "Shoqëri në Likujdim e Sipër".


Me miratimin e likujdimit, Shoqëria i jep fund veprimtarisë.

NENI 29

Kompetencat e Asamblese se Ortakeve gjate likujdimit

Asambleja e Ortakëve vendos mbi rregullshmërinë e likujdimit, për të vodosur përbilancin e likujdimit dhe heqjen e mandatit të likuidatorit.

Asamblea e Ortakëve mund të kërkojë edhe vetë realizimin e kësaj mbledhjeje, në rast se likuidatori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga Gjykata mbi propozimin e njërit prej Ortakëve ose të një mandatmbajtësi.

NENI 30

Mbyllja e likujdimit

Kur Asamblea e Ortakëve, pa shkaqe të arsyeshme nuk vendos për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likujdimit. Aktet e mbylljes së likujdimit, së bashku me llogaritë përkatëse përfundimtare, depozitohen në regjistrin tregtar.

Mbas mbylljes së likujdimit dhe depozitimit të dokumentacionit në regjistrin tregtar, Shoqëria çregjistrohet prej tij.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT.

NENI 31

Përgjegjësia kundrejt shoqërisë

Nëpunësit, të zgjedhurit nga Asamblea e Ortakëve, e personat që punojnë për llogari të saj, mbajnë përgjegjësi penale e civile sipas nenit 296, 297, 301 të ligjit “Për Shoqëritë Tregtare” kur me dashje shkelin detyrat e ngarkuara e i shkaktojnë humbje Shoqërisë.

NENI 32

Hyrja në fuqi


Statuti hyn në fuqi mbas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

ORTAKET THEMELUES

Dionis TEQJA


Dionis Teqja

Fatos ALIAJ


Fatos Aliaj